



Lajmet e Fundit:

Shkodër – Goditet një rast i shpërndarjes së lëndëve narkotike në afërsi të shkollave, vihet në pranga 1 shtetas



14/02/2022

Durrës – Goditet një tjetër rast i armëmbajtjes pa leje

Sekuestrohen një thikë pistoletë dhe një sasi municioni luftarak.

Vihet në pranga 19-vjeçari që i posedonte.

Në vijim të kontrolleve të ushtruara nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Durrës, falë edhe bashkëpunimit me qytetarët, të cilët përditë e më shumë po bashkëpunojnë me Policinë, duke denoncuar çdo rast të paligjshmërisë, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit F. C., 19 vjeç, banues në Sukth, Durrës.

Gjatë kontrollit në banesën e tij, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një thikë pistoletë dhe një sasi fishekësh.

Materialet hetimore i kaluan për ndjekje Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Durrës falënderon qytetarët që besojnë dhe bashkëpunojnë me Policinë, për të parandaluar dhe goditur paligjshmërinë, me qëllim krijimin e një ambienti sa më të sigurt.

Share

Share

Share

Share

Email

◀ Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Four”


Elbasan – Vihet në pranga 1 shtetas, procedohet penalisht 1 tjetër ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month



Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)